

POLITIKAT E PRIVATËSISË

Me hyrjen tuaj në këtë faqe interneti, ju pranoni se keni lexuar dhe pranuar kushtet e mëposhtme:

Kjo politikë ju informon se shkolla jopublike “Viktor HYGO” mbledh dhe përpunon të dhënat personale të punonjësve të saj, nxënësve, prindërve, vizitorëve dhe aplikantëve për punë në përmbushje të të drejtave dhe detyrimeve të saj ligjore dhe kontraktuale dhe në përputhje të plotë me Ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008, « Për mbrojtjen e të dhënave personale » (të ndryshuar), si dhe ligjin 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri’ i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Objekti i Politikës së Privatësisë

Ky dokument ka për objekt informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes të të dhënave personale që deklarohen në faqen e internetit, procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë.

Shkolla jopublike “Viktor HYGO” siguron çdo përdorues se të dhënat që mbërrijnë në bazën e të dhënave të saj i siguron me sistemin e sigurisë më të lartë dhe njëkohësisht është e përkushtuar të zbatojë rigorozisht të gjithë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të çdo veprimi të lidhur me të dhënat e përdoruesve, ashtu sic edhe përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji në fuqi (Nr. 9887), datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012) “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Faqa zyrtare e internetit të **shkollës jopublike “Viktor HYGO”** është www.ecole-vhugo.com. Në këtë faqe përdoruesi mund të hasë forma apo formularë të ndryshëm, aplikimi (psh. Njoftime për vende të lira pune nga punëdhënësi, njoftime për konkurse apo çmime organizuar nga institucioni, formularë regjistrimi etj). Në fusha të ndryshme të këtyre formateve apo formularëve mund të lindë nevoja për të futur të dhëna personale.

Shkolla jopublike “Viktor HYGO” siguron çdo individ se të dhënat e tyre mblidhen dhe përpunohen vetëm për qëllime të realizimit të marrëdhënies kontraktore. Duke përdorur portalin e **shkollës jopublike “Viktor HYGO”** duke dhënë miratimin për regjistrimin, individët apo përfaqësuesit ligjor të individëve, apo kujdestare ligjor të fëmijëve të dhënave japin pëlqimin për procesimin e mëtejshëm të tyre si dhe garantojnë që të dhënat personale të plotësuara janë të sakta, të vërteta dhe të përditësuara.



POLITIKAT E PRIVATËSISË

Shkolla jopublike “Viktor HYGO” garanton se ka marrë të gjitha masat fizike, teknike dhe operacionale për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe mbrojtjen nga humbja, shkatërrimi, dëmtimi apo edhe shpërndarja e pautorizuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008, « Për mbrojtjen e të dhënave personale » (i ndryshuar) .

Të dhënat personale, të mbledhura dhe të ruajtura në **shkollën jopublike “Viktor HYGO”**, do të përpunohen nga personat e ngarkuar me përpunimin. Këto të dhëna nuk do të transferohen ose komunikohen te palët të treta, përveç rasteve kur është dhënë pëlqimi ose kur ky informacion kërkohet nga organet kompetente sipas ligjit.

Pyetje/ ankesa /informacione

Me anë të informacionit të mësipërm shpresojmë t’ju kemi informuar në mënyrë të plotë rreth çështjeve të privatësisë, në funksion të përdorimit të faqes së internetit të **shkollës jopublike “Viktor HYGO”**.

Për çdo kërkesë, informacion apo problematikë të mundshme në lidhje me faqen tonë të internetit: www.ecole-vhugo.com lutemi kontaktoni.

Shkolla jopublike “Viktor HYGO”

Rruga: “Tre Vëllezërit Kondi”, Tiranë, Shqipëri

e-mail: info@ecole-vhugo

